

Statistikat e transportit*

Dhjetor 2022

Tiranë, më 27 Janar 2023: Statistikat e Transportit sipas llojeve, për muajin Dhjetor 2022, paraqiten si në vazhdim:

Volumi i mallrave të transportuar me ajër është 176,6 ton, duke u ulur me 11,7 % në krahasim me Dhjetor 2021.

Volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte, është 309.1 mijë ton, duke u ulur me 17,4 %, krahasuar me Dhjetor 2021.

Volumi i mallrave të transportuara me hekurudhë është 1.739 mijë ton-kilometër, duke u rritur me 6,2 %, krahasuar me Dhjetor 2021.

Tab. 1 Transporti i mallrave me det, hekurudhë dhe ajër

Periudha	Transporti i mallrave		
	Me det / ton	Hekurudhë 000/ton.km	Ajër / ton*
Dhjetor 2021	374.207	1.638	200,0
Dhjetor 2022	309.084	1.739	176,6
Ndryshimi vjetor (%)	-17,4	6,2	-11,7
Janar-Dhjetor 2021	4.839.617	25.115	2.035,8
Janar-Dhjetor 2022	3.840.418	19.983	2.064,7
Ndryshimi vjetor (%)	-20,6	-20,4	1,4

* Përfshin mallrat dhe postën

Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, llogaritje të INSTAT

Në vitin 2022, situata e Statistikave të Transportit sipas llojeve, paraqitet si në vijim:

Volumi i mallrave të transportuar me ajër është 2.064,7 ton, duke u rritur me 1,4 %, krahasuar me vitin 2021.

Volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte është 3.804,4 mijë ton, duke u ulur me 20,6 %, krahasuar me vitin 2021.

Volumi i mallrave të transportuar me hekurudhë është 19.983 mijë ton-kilometër, duke u ulur me 20,4 %, krahasuar me vitin 2021.

Për publikim 27/01/2023

Vijon

* Ky publikim nuk përfshin volumin e mallrave dhe numrin e pasagjerëve të transportuar nëpërmjet transportit rrugor.

Tab. 2 Treguesit specifike të transportit ajror

Periudha	Numri i shoqërive ajrore*	Numri i fluturimeve	Numri i mbikalimeve
Dhjetor 2021	17	2.408	10.405
Dhjetor 2022	17	3.018	12.470
Ndryshimi vjetor (%)	0,0	25,3	19,8
Janar-Dhjetor 2021	17	26.334	129.210
Janar-Dhjetor 2022	17	39.062	213.917
Ndryshimi vjetor (%)	0,0	48,3	65,6

*Numri i kompanive ajrore i referohet numrit të kompanive të cilat janë licensuar të kryejnë fluturime në fillim të vitit

Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, llogaritje të INSTAT

Në Dhjetor 2022, treguesit mbi numrin e fluturimeve dhe numrin e pasagjerëve, paraqiten si në vijim:

Numri i fluturimeve është 3.018 duke u rritur me 25,3 %, krahasuar me muajin Dhjetor 2021.

Numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar me linja ajrore është 408.137 pasagjerë, duke u rritur me 50,4 %, krahasuar me Dhjetor 2021.

Numri i pasagjerëve që udhëtojnë me linjë detare është 75.237 pasagjerë. Krahasuar me Dhjetor 2021, ky tregues është rritur me 27,3 %.

Numri i pasagjerëve që udhëtojnë me linjë hekurudhore është 123 pasagjerë. Krahasuar me Dhjetor 2021, ky tregues është ulur me 83,9 %.

Në muajin Dhjetor 2022, transporti ajror i pasagjerëve zë 84,4 % të transportit gjithsej.

Në vitin 2022, treguesit mbi numrin e pasagjerëve, paraqiten si në vijim:

Numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar me linja ajrore është 5.238.302 pasagjerë, duke u rritur me 78,9 %, krahasuar me vitin 2021.

Numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar me linjë detare 1.367.008 pasagjerë, duke u rritur me 58,4 %, krahasuar me vitin 2021.

Numri i pasagjerëve që udhëtojnë me linjë hekurudhore është 10.604 pasagjerë, duke u ulur me 55,8 %, krahasuar me vitin 2021.

Tab.3 Transporti i pasagjerëve sipas mënyrës së udhëtimit

Periudha	Transporti i pasagjerëve		
	Me hekurudhë	Me det	Me ajër
Dhjetor 2021	766	59.100	271.340
Dhjetor 2022	123	75.237	408.137
Ndryshimi vjetor (%)	-83,9	27,3	50,4
Janar-Dhjetor 2021	24.018	862.757	2.928.275
Janar-Dhjetor 2022	10.604	1.367.008	5.238.302
Ndryshimi vjetor (%)	-55,8	58,4	78,9

Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, llogaritje të INSTAT

Eksportet/importet e mallrave sipas mënyrës së transportit

Në Dhjetor 2022, volumi i mallrave të tregtuara (eksport dhe import) është 743,1 mijë ton ku 58,5 % e tyre u transportua me det.

Në vitin 2022, volumi i mallrave të tregtuara (eksport dhe import) është 9.000,6 mijë ton ku 55,2 % e tyre u transportua me det.

Eksportet e mallrave

Në Dhjetor 2022, volumi i mallrave të eksportuara me tokë zë 52,3 %, me det 47,6 % dhe të tjera 0,1 %.

Volumi i mallrave të eksportuara me det është rritur 1,1 %, ndërsa me tokë është ulur me 15,6 % dhe me ajër është ulur me 15,7 %, krahasuar me Dhjetor 2021.

Tab.4 Eksporti i mallrave sipas mënyrave të transportit


Periudha	Eksport (ton)				
	Me det	Me hekurudhë	Me tokë	Me ajër	Të tjera
Dhjetor 2021	144.310	-	189.753	20	45
Dhjetor 2022	145.967	-	160.220	17	66
Ndryshimi vjetor (%)	1,1	0,0	-15,6	-15,7	48,4
Janar-Dhjetor 2021	1.727.251	961	2.610.941	219	1.136
Janar-Dhjetor 2022	1.748.287	1.824	2.159.604	233	755
Ndryshimi vjetor (%)	1,2	89,8	-17,3	6,4	-33,5

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, llogaritje të INSTAT

Në vitin 2022, volumi i mallrave të eksportuara me tokë zë 55,2 %, me det 44,7 % dhe 0,1 % me hekurudhë.

Volumi i mallrave të eksportuara me hekurudhë është rritur me 89,8 %, me ajër është rritur me 6,4 % dhe me det është rritur me 1,2 %, ndërsa volumi i mallrave të eksportuara me tokë është ulur me 17,3 %, krahasuar me vitin 2021.

Fig. 1 Struktura e eksporteve sipas mënyrës së transportit, Dhjetor 2022



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, llogaritje të INSTAT

Importet e mallrave

Në Dhjetor 2022, volumi i mallrave të importuara me det zë 66,1 %, me tokë 33,1 % dhe të tjera 0,8 %. Volumi i mallrave të importuara me det është ulur me 1,3 %, me ajër është ulur me 8,9 % dhe me tokë është ulur me 17,0 % krahasuar me Dhjetor 2021.


Tab.5 Importi i mallrave sipas mënyrave të transportit

Periudha	Import (ton)				
	Me det	Me hekurudhë	Me tokë	Me ajër	Të tjera
Dhjetor 2021	292.530	690	174.272	124	3.805
Dhjetor 2022	288.759	-	144.592	113	3.385
Ndryshimi vjetor (%)	-1,3	-100,0	-17,0	-8,9	-11,0
Janar-Dhjetor 2021	3.341.358	31.583	2.036.376	1.539	33.832
Janar-Dhjetor 2022	3.219.508	2.780	1.827.535	1.306	38.722
Ndryshimi vjetor (%)	-3,6	-91,2	-10,3	-15,1	14,5

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. llogaritje të INSTA

Në vitin 2022, volumi i mallrave të importuara me det zë 63,3 %, me tokë 35,9 %, me hekurudhë 0,1 % dhe të tjera 0,7 %. Volumi i mallrave të importuara me hekurudhë është ulur me 91,2 %, me ajër 15,1 %, me tokë 10,3 % dhe me det është ulur me 3,6 %, krahasuar me vitin 2021.

Fig. 2 Struktura e importeve sipas mënyrës së transportit, Dhjetor 2022



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, llogaritje të INSTAT

Metodologjia

Publikimi i Statistikave të Transportit paraqet rezultatet mbi transportin e mallrave dhe pasagjerëve si dhe eksportin dhe importin e mallrave sipas mënyrës së transportit në frekuencë mujore. Të dhënat janë administrative. Burimi kryesor i informacionit është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Përkufizime

Transport: Lëvizja e njerëzve dhe/ose mallrave duke përdorur mjete të ndryshme transporti. Transporti mund të kryhet me mjete të transportit hekurudhor, tokësor, detar dhe ajror.

Transporti hekurudhor: Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur mjete me rrota të drejtuar mbi binarë.

Transporti tokësor: Çdo lëvizje e mallrave duke përdorur një mjet rrugor në një rrjet të caktuar rrugor.

Transport detar: Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur anije tregtare në udhëtime të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me det.

Transport ajror: Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur avionë në udhëtime të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me ajër.

Eksportet: Janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv, ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

Importet: Janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Nomenklatura e Statistikave të Transportit (NST 2007): Është një nomenklaturë statistikore e cila përdoret për mallrat e transportuara nëpërmjet katër mënyrave të transportit: rrugë, hekurudhë, rrugë ujore të brendshme dhe det.

Të dhënat e transportit detar, ajror dhe hekurudhor janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë, referohu: [Politika e Revizionit Statistikor](#).

Shpjegimi i simboleve

0 vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

- pa vlerë

(...) mungesë të dhënash